

**JUSUF BAJRAKTARI**

**LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT  
PROJEKT PËR SHTETIN KOMBËTAR\***

Traktati i Paqes së Shën Stefanit (3 mars 1878) krijoi një konfiguracion të ri gjeopolitik në Evropën Juglindore, që u shërbente qëllimeve ekspansioniste të Ruisë. Ky Traktat i këpuste Perandorisë Osmane rreth 80 për qind të zotërime të saj në Ballkan. Në këtë kontekst Serbisë, Malit të Zi dhe Rumanisë u jepej pavarësia. Bullgaria ishte përfituesja më e madhe duke rritur për afro tri herë sipërfaqen e saj. Ajo edhe pse fitoi një autonomi të brendshme edhe më tutje mbeti nën sovranitetin formal të Perandorisë Osmane.

Pra, politika ruse ekspansioniste dhe antishqiptare ka një traditë të gjatë më tepër se 130-vjeçare, që në forma e mënyra të ndryshme pengon konsolidimin normal të faktorit shqiptar në rajon. Mirëpo, kjo politikë ekspansioniste qysh atëherë u identifikua nga fuqitë perëndimore si shkak i kryesor i prishjes së barazpeshës dhe ekuilibrave politike në Ballkan.

Vendimet e padrejta të Shën Stefanit rënduan mbi kurrizin e popullit shqiptar duke e shndërruar atë në prenë e gjahut të luftës dhe duke e ndëshkuar për humbjet e Perandorisë Osmane në rënie. E gjithë kjo realizohej në emër të mbrojtjes së ortodoksisë dhe shteteve sllave, prapa së cilës qëndronte ideologjia pansllaviste ruse. Dhe pikërisht këtu do të takohen e gërshetohen interesat vitale të popullit tonë si një vektor i ndërthurur me karakterin e ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare siç është Kongresi i Berlinit, i cili pretendonte të rishikonte marrëveshjen e prishjes së ekuilibrave dhe të statuskuosë së Shën Stefanit.

Komiteti i Stambollit, që u formua më 18 dhjetor 1877, përbëhej nga personalitete të njohura shqiptare që përfaqësonin pothuajse të gjitha krahinat e Shqipërisë. Kryetar i Komitetit u zgjodh Abdyl Frashëri, kurse anëtar të tij ishin: Pashko Vasa, Jani Vreto, Ymer Prizreni, Zija Prishtina, Ahmet Korenica, Mihal Harito etj. Në programin politik të Komitetit të Stambollit spikat teza mbi organizimin e kryengritjes së armatosur kundër osmane dhe krijimin e shtetit kombëtar shqiptar që në fakt ravizon premisat e një projekti kombëtar. Në këtë periudhë u zhvilluan edhe bisedimet e pasuksesshme shqiptaro-greke, të cilat u ndërpre në për shkak të situatës së disfavorshme ndërkombëtare dhe

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Kombëtare “Shqiptarët përballë sfidave të bashkimit dhe të lirisë”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 13 qershor 2008.

rrezikut që i kërcënohej tërësisë territoriale nga fqinjët. Nën këtë trysni e gjendje të re, shqiptarët u kthyen përsëri në programin e mëparshëm. Në vend të pavarësisë së plotë ata vendosën të kërkonin bashkimin e trojeve të tyre amtare në një vilajet autonom shqiptar në kuadër të Perandorisë Osmane. Për të arritur bashkimin politik dhe organizativ të mbarë vendit rreth kësaj platforme, udhëheqësit e Komitetit të Stambollit vendosën të formonin një Lidhje Shqiptare me karakter kombëtar, ku do të përfaqësoheshin të gjitha shtresat shoqërore dhe të gjitha krahinat shqiptare që bënin pjesë në katër vilajetet: në atë të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës. Projektin për formimin e Lidhjes e përgatiti qysh në fillim të vitit 1878, Pashko Vasa, që në atë kohë ishte këshilltar i valiut të Kosovës.

Në memorandumin që Pashko Vasa u paraqiti në emër të shqiptarëve, përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Stamboll, në mars të vitit 1878, theksohej se nëse ato (Fuqitë e Mëdha) do u jepnin Bullgarisë, Serbisë, Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës vetëqeverisjen e t'i shkëpusnin nga Perandoria Osmane, nuk do të ketë asnjë arsye që t'i detyrojnë shqiptarët, që janë të vendosur t'i këpusin zinxhirët që i lidhin me Turqinë, të heqin dorë nga aspirata e tyre për një qeverisje autonome dhe për të hyrë në rrugën e qytetërimit.

Pezullimi i Traktatit të Shën Stefanit deri në thirrjen e Kongresit të Berlinit u jepte në dorë patriotëve shqiptarë një kohë të çmueshme për ta organizuar më mirë qëndresën e tyre politike e ushtarake. Nga ana tjetër, leja që kishte kërkuar Komiteti i Stambollit për të formuar një Lidhje Shqiptare, ndeshi në kundërshtimin e Portës së lartë. Ajo nuk pranonte në asnjë mënyrë që kjo lëvizje të zhvillohej e të organizohej si Lëvizje Kombëtare Shqiptare, por që shqiptarët të protestonin kundër Traktatit si nënshtetas myslimanë pa pretendime të shkëputjes nga Porta, gjë që për ta ishte e papranueshme. Prandaj gjatë pranverës së vitit 1878, krahas hovit të lëvizjes së protestës, ngadhënjeu edhe ideja për të kundërshtuar me armë çfarëdo vendimi që do të dëmtonte tërësinë tokësore të atdheut. Siç del nga dokumentet e kohës si kudo, edhe në trojet shqiptare, detyra e bashkimit me një platformë kombëtare do t'i takojë inteligjencies përparimtare shqiptare. Kjo ishte e natyrshme sepse inteligjenca ishte ajo që i kuptonte më mirë dhe më drejtë kërkesat historike që shtronte koha. Ajo dinte t'i bashkonte në një aspiratë të vetme – dëshirën e popullit për liri, të ngjallte frymën luftarake të të gjitha shtresave të popullsisë shqiptare me interesat e borgjezisë dhe të asaj shtrese të çifligarëve e cila kishte ndikim në shoqërinë shqiptare dhe që ishte e interesuar për zgjidhjen e detyrave të lëvizjes kombëtare. Të gjitha këto u kanalizuan në hullinë e aspiratave kombëtare shqiptare, duke lënë mënjanë interesat e pjesshme të grupeve dhe shtresave të caktuara shoqërore. Në këtë mënyrë u arrit të miratohej Programi politik për sigurimin e autonomisë së viseve të banuara me shqiptarë, si hapi i parë drejt pavarësisë së plotë.

Kjo fazë e LKSH karakterizohet me formimin dhe veprimtarinë e një qendre udhëheqëse të Lëvizjes për autonomi gjatë viteve 1878-1881. Kjo ishte kërkesa themelore që do të sillte bashkimin e viseve të banuara nga shqiptarët në një njësi autonome shtetërore.

Në rrethana të këtilla të vështira, në një koniunkturë politike të ndërlikuar dhe të disfavorshme për popullin shqiptar, përfaqësuesit e viseve shqiptare u mblodhën në qytetin historik të Prizrenit më 10 qershor 1878, si sot e 130-vjet më parë dhe themeluan Lidhjen Shqiptare. Siç shihet forca e mendjes së ndritur të një diplomati të shquar siç ishte Abdyl Frashëri gjeti truallin e përshtatshëm të dija dhe guximi i figurave të shquara të Rilindjes tonë, siç ishin: Ymer Prizreni, deputet i Vilajetit të Kosovës në Parlamentin osman e i përkrahur edhe nga Iljaz pashë Dibra (Qoku), i cili do të promovohet kryetar i parë i kësaj organizate.

Lidhja me qëllim që të vejë në lëvizje potencialin e saj zgjodhi në krye një Komitet Qendror me seli në Prizren. Komiteti gjatë kohës do të vepronte si një parlament. Ai kishte për detyrë të formonte degët e Lidhjes në qendrat më të rëndësishme të vendit. Në këtë Komitet do të funksiononin organet operative të caktuara për punë të jashtme, për punë të brendshme dhe për financa. Kryetar i Komitetit Qendror u zgjodh Ymer Prizreni, ndërsa Sulejman Vokshi u ngarkua me detyrën e kryetarit të Komisionit të Financave. Anëtarë të këtij komiteti ishin edhe Ali pashë Gucia, Sheh Mustafë Tetova, Myderriz Osman Efendiu nga Prizreni etj. Abdyl Frashëri do të drejtonte komisionin për punë të jashtme. Kjo formë organizimi e veprimi në terren do të fuqizohej e do të merrte tiparet e një qeverie në mbarë hapësirën kombëtare.

Kuvendi i Parë i Lidhjes miratoi si dokument të vetin Kararnamenë në të cilën nuk u arrit të përfshiheshin kërkesat e krahut autonomist të Lidhjes. Në këtë akt ndihej dora e valiut të Kosovës dhe ndikimi i krahut të Sulltanit, që shfaqej sidomos në tezën mbi respektimin e sovranitetit të Sulltanit dhe në frymën e saj islamike, që natyrisht rrezikonte pavarësinë e synimeve të Lidhjes.

Për shkak të kësaj fryme, shumica e delegatëve nuk e nënshkruan Kararnamenë. Nga 100 veta do ta nënshkruajnë vetëm 49 ose 44%. Përveç Kararnamesë Kuvendi që në fillim të punës së vet më 17 qershor, miratoi edhe Urdhëresën ose Talimatën ku Lidhja trajtohej si një organizatë politike e ushtarake. Lidhja do të formonte një administratë qendrore me seli në qytetin e Prizrenit ku do të kishte përfaqësues nga të gjitha sanxhaqet dhe një ushtri që do të ishte e pavarur nga Porta e Lartë dhe do t'i shërbente mbrojtjes së tërësisë territoriale shqiptare. S'ka dyshim se këto organizma do të shërbejnë si instanca të një shteti në lindje dhe në konsolidim.

Porta e Lartë u përpoq që Kuvendit të Lidhjes dhe veprimtarisë së tij t'i jepte një karakter islamik mirëpo për fat të mirë nuk e arriti qëllimin. Udhëheqja e Lidhjes qysh më 15 qershor 1878 i drejtoi Portës së Lartë një peticion ku thuhej: *“Në kohën kur atdheu na fton në shërbim të tij, interesat*

*personale qofshin mallkuar. Në Lidhjen tonë kemi vendosur që mos t'i nënshtrohemi fesë sepse në radhë të parë jemi shqiptarë*". Ky dokument që në fillim argumenton se shqiptarët pavarësisht përkatësisë fetare tre kofensionale ishin të vendosur si një popull i formuar tashmë mbi parimin e një platforme programatike kombëtare.

Lidhja e Prizrenit, siç do të shprehet Lumo Skëndo në revistën "Leka" më 1938, me rastin e 60-vjetorit të saj, është fryma e bashkimit kombëtar që merr mbi vete orientimin e ideve dhe veprimeve të reja, duke afruar degët e jugut me ato të veriut. Sepse ardhja e Abdyl Frashërit në Prizren ishte shprehje e një ideje dhe ideali të ri rreth të cilit do të bashkohen figura të shquara të Rilindjes tonë siç ishin Ymer Prizreni, Iljaz Pashë Dibra, Sulejman Vokshi, Ali pashë Gucia, Ahmet Korenica, Sheh Mustafë Tetova e të tjerë.

Në këto kushte taktika e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare nuk mund të orientohej drejt e vetëm kundër Portës, siç ndodhte te popujt e tjerë ballkanas. Ajo duhet të luftonte në dy fronte: kundër politikës pushtuese të monarkive ballkanike, si dhe kundër Portës për mbrojtjen e integritetit tokësor dhe të unitetit të saj kombëtar. Por asnjë nga këto qëllime nuk mund të sigurohej ndryshe veçse me luftë për afirmimin e plotë të parimit të kombësisë kundër faktorëve kundërshtarë: qeverive fqinje dhe Portës.

Ishte e qartë se për mbrojtjen e integritetit të zotërimeve të saj, ishte vetë Porta po aq e interesuar. Në këtë kuptim, interesat e shqiptarëve me ato të portës në këtë moment shkonin dorë më dorë. Nga ana tjetër, pikërisht situata e vështirë në të cilën ndodhej Porta, krijonte mundësinë për ta detyruar atë që të dekretonte në mënyrë "vullnetare" autonominë e Shqipërisë, për të ruajtur të paktën në këtë formë një pjesë të sovranitetit të saj në perëndim të Ballkanit. Në këtë kuadër vepronte me kujdes dhe premtime edhe Porta, duke dashur të inkurajonte shqiptarët për të kundërshtuar ndryshimet territoriale. Duke u nisur nga interesat e Portës për të organizuar në provinca vetëmbrojtjen lokale, pasi ajo vetë i kishte duart e lidhura nga traktatet e nënshkruara, Lidhja me anë përkrahësish me influencë pranë oborrit, mori lejen për të përkrahur në Shqipëri një milici vullnetare shqiptare, që filloi të përdorte dhe armatimet e ushtrisë së rregullt. Në planet e Komitetit synohej që kjo forcë të përdorej në rastin e volitshëm edhe për të shkëputur nga Sulltani statusin e autonomisë së Shqipërisë.

Kjo taktikë e luftës në dy fronte dhe e aleancës së kushtëzuar me Portën, u zbatua nga Lidhja Shqiptare dhe nga forcat e varura prej saj në një mënyrë pak a shumë konsekuente, me gjithë vështirësitë që dilnin vazhdimisht nga Porta, pasi kaloi "tronditja" e parë.

Nëse Komiteti Qendror i Lidhjes arriti t'i përballojë këto vështirësi të ndryshme, kjo ndodhi se Lëvizja Kombëtare Shqiptare tashmë nuk ishte më

vetëm një lëvizje iluministe intelektualësh, por kishte prapa saj forcën e armëve që ishte gati për mbrojtjen e tokave të tyre.

Sipas projektit të miratuar në Këshillin Qendror të Lidhjes menjëherë pas mbajtjes së Kuvendit Themelues u formuan celulat e të gjitha organeve të pushtetit lokal nëpër qendrat kryesore, fillimisht në vilajetin e Kosovës e pastaj u degëzuan shumë shpejt që nga veriu e në jug të Shqipërisë.

Kjo shpejtësi e ngritjes së institucioneve gjatë periudhës kur Kongresi i Berlinit zhvillonte punimet (13 qershor – 13 korrik 1878) habiti Portën e Lartë, sikurse dha shkas edhe për ata që Lidhjen ishin të prirur për ta identifikuar me Stambollin. Së shpejti kjo formulë dashakeqe do të gjente epilogun e merituar në ngjarjet dramatike të Gjakovës të 6 shtatorit 1878 kur u vra i deleguari i Sulltanit dhe kështu Lidhja dëshmoi katërcipërisht se nuk ishte dorë e zgjatur e Portës siç e etiketonin armiqtë e kombit shqiptar. Ajo dëshmonte se ishte një organizatë politike-ushtarake atdhetare e cila në këto çaste historike u vu në krye të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për të përmbushur misionin e saj programatik.

Ngjarja e Gjakovës, siç u quajt atëherë nga bashkëkohësit kryengritja e popullit të qytetit dhe malësisë së tij dhe vrasja e Mehmet Ali Pashës përfaqësuesit të Portës në Kongresin e Berlinit, pati një jehonë në tërë Evropën. Lipih – kryekonsulli i Austro-Hungarisë në Shkodër duke e vlerësuar këtë si ngjarje tepër të rëndësishme politike, i raportonte më 11 shtator 1878 ministrit të Punëve të jashtme, Adrashit në Vjenë se *“në rrethana të tilla nuk do të ishte çudi që zjarri i kryengritjes së atyre viseve të përhapte flakën e tij në të gjitha drejtimet ... kryengritësit dhe Lidhja e zotërojnë sot gjendjen politikisht”*. Kjo ngjarje u kujtonte vëzhguesve diplomatikë të kohës Komunën e Parisit.

Në zhvillimet historike në rrjedhën e viteve dhe shekujve ka ngjarje që për domethënie të tyre, qëndrojnë si udhërrëfyese në udhëkryqet e mëdha të historisë. Pa dyshim se një nga ato ngjarje që i dha popullit shqiptar një përgjigje që zë vend nderi në histori është themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në këtë ditë të para 130-vjetësh, në qytetin e lashtë të Prizrenit, përfaqësues të zgjedhur të viseve shqiptare shpallën vendosmërinë e tyre për të luftuar për të drejtat e veta kombëtare dhe vunë themelet e një organizate politike e ushtarake me premisa të një shteti në shtet. Lidhja e Prizrenit për tre vjet me radhë udhëhoqi luftën e popullit tonë për çlirim nga zgjedha e huaj shekullore, për mbrojtjen e trojeve të veta, për bashkimin në një shtet të vetëm autonom e të njësuar kombëtar.

Mund të përfundojmë se pikërisht në Kuvendet e Lidhjes dhe në veprimet e saj u afirmua ideja për projektin e shtetit shqiptar me orientime të qarta të qytetërimit perëndimor. Të gjitha këto fakte flasin bindshëm e me argumente të qëndrueshme se Lidhja Shqiptare e Prizrenit pavarësisht lëkundjeve nëpër kundërrthëniet e kohës ka ngjel projektin themeltar i shtetit modern shqiptar, shkëlqimi i së cilës nuk shuhet kurrë.

